



RAPORTI VJETOR I PUNËS SË POLICISË SË KOSOVËS 2024

info@kosovopolice.com

www.kosovopolice.com

POLICIA E KOSOVËS

Titulli i raportit:	Raporti vjetor i punës së Policisë së Kosovës Janar - Dhjetor 2024
Përpiluesi:	Toger Fahrije LUTFIU Shef i Sektorit Qendror për Statistikë dhe Analizë Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore
Mbikëqyrur nga:	Kolonel Riza SHILLOVA Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore
Raporti është aprovuar nga:	Kolonel Fehmi HOTI Zëvendësdyrëtor i Përgjithshëm i Policisë Kolonel Gazmend HOXHA Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Republikës së Kosovës
Lektor:	Drejtoria për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
Përkthim në gjuhën angleze dhe serbe:	Spektori i përkthimeve Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
Dizajni grafik:	Çajup KAJTAZI Drejtoria për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Spektori Qendror për Statistikë dhe Analizë Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore Policia e Republikës së Kosovës

Policia e Republikës së Kosovës



-  www.kosovopolice.com
-  www.facebook.com/KosovoPolice
-  twitter.com/Kosovo_Police
-  info@kosovopolice.com

Aplikacioni lajmëro Policinë

PLAN BAJTI BAND ZEM RE E D

04.

Lista e shkurtesave

05.

Mesazhi i drejtorit të
Përgjithshëm të Policisë

07.

Përmbledhje ekzekutive

09.

Siguria, rendi dhe qetësia
publike

12.

Siguria në trafikun rrugor

14.

Policimi në bashkësi

15.

Parandalimi dhe luftimi i
krimit të organizuar

22.

Shërbimet Mbështetëse

24.

Bashkëpunimi me
publikun

Lista e shkurtesave

BKQ	Banka Qendrore e Kosovës
CT	Tomografia e kompjuterizuar
DBNP	Drejtoria e Bashkëpunimit Ndërkombëtar Policor
DEXA	Testi i densitetit kockor
EEG	Elektroencefalogram
EMNG	Elektromioneurografia
EKG	Elektrokardiograma
HTA	Hipertensioni Arterial
DHKEK	Drejtoria e Hetimit të Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit
DHTN	Drejtoria e Hetimit të Trafikimit me Narkotikë
DHKOKR	Drejtoria e Hetimit Të Krimit të Organizuar dhe krimeve të Rënda
DIA	Departamenti i Intelejencës dhe Analizës
DRP	Drejtoria Rajonale e Policisë
DMA	Drejtoria për Mbrojtje të Afërt
DSHSH	Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore
EUROPOL	Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Zbatimin e Ligjit
FAST	Ekipi për Kërkim Aktiv të të arrestuarve
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës
MRI	Rezonancë Magnetike
NJHR	Njësia e Hetimeve Rajonale
QNJS	Qendra e Njësive Speciale
RKS	Republika e Kosovës
RTK	Radiotelevizioni i Kosovës
VIP	Persona të rëndësishëm



Mesazhi i drejtorit të përgjithshëm të Policisë

Kolonel Gazmend HOXHA

Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Republikës së Kosovës

Me kënaqësi të madhe përmes këtij raporti vjetor prezantojmë përmbledhjen e aktiviteteve të Policisë së Kosovës për vitin 2024. Ky është një moment i rëndësishëm, ku reflektojmë mbi arritjet, sfidat dhe përpjekjet tona për të ofruar shërbime cilësore policore për një shoqëri më të sigurt.

Në vitin 2024, Policia e Kosovës ka përmbushur një gamë të gjerë objektivash, që synojnë forcimin e rendit dhe sigurisë, përmirësimin e bashkëpunimit me komunitetin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e kufirit shtetëror si dhe parandalimin dhe luftimin e terrorizmit, krimit të organizuar dhe krimeve tjera të rënda. Raporti është pasqyrim i arritjeve tona në realizimin e synimeve, objektivave dhe aktiviteteve të planifikuara paraprakisht.

Të dhënat e paraqitura në këtë raport pasqyrojnë arritjet e Policisë në ballafaqimin edhe me aktet dhe aktivitetet e kundërligjshme dhe sfidat tjera për Policinë. Në këtë kontekst Policia në maksimum ka përdorur në mënyrë efikase kapacitetet e saj, përfshirë burimet njerëzore, resurset tjera materiale, logjistike, teknike dhe teknologjike në dispozicion.

Gjatë këtij viti Policia si rezultat i angazhimit policor ka trajtuar gjithsej 48,615 raste, nga të cilat 27,865 vepra penale, janë arrestuar 15,297 persona si dhe janë konfiskuar 1,746 armë. Një nga arritjet më të rëndësishme është ulja e numrit të vrasjeve me 41.37%, si dhe rënia e rasteve të lëndimeve të rënda trupore dhe vjedhjeve të rënda, ku kemi një rënie të këtyre rasteve për 21.07% si dhe numri i grabitjeve ka shënuar rënie për 22.58 % krahasuar me vitin paraprak. Megjithatë, kemi parë një rritje të numrit të rasteve të dhunës në familje për 3.53 %, një fushë ku Policia e Kosovës vazhdon të fokusohet për të ofruar mbështetje dhe për të parandaluar këto dukuri të dëmshme.

Në lidhje me trafikun rrugor, me qëllim të kontributit në rënien e aksidenteve dhe fataliteteve në rrugë janë ndërmarrë masa të fuqishme për të përmirësuar sigurinë dhe për të reduktuar aksidentet. Policia ka realizuar 17 plane operationale dhe ka organizuar 90 fushata vetëdijesuese.

Në luftën kundër aktiviteteve policore të orientuara në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, krimeve të rënda, krimit ekonomik dhe korrupsionit, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, është punuar në gjithsej 1,471 raste, janë realizuar 278 operacione, janë goditur 28 grupe kriminale.

Në kuadër të menaxhimit dhe kontrollit të kufirit janë menaxhuar një numër i madh i kalimeve kufitare, ku gjatë këtij viti përmes kufijve të Kosovës kanë kaluar 30,503,299 persona me një ngritje për 11.72%; 8,823,558 mjete motorike, që tregon ngritje për 11.86% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Gjatë vitit 2024, janë realizuar 431 patrullime të përbashkëta dhe janë ndërmarë 54 operacione, për të siguruar kufijtë e Kosovës dhe për të parandaluar aktivitete të paligjshme ndërkufitare.

Aktivitetet e Policisë janë realizuar gjithnjë në përputhje me Strategjinë e Integruar të Policimit dhe Planin e Veprimit 2021-2025, me ç'rast është rritur bashkëpunimi me komunitetin, ku janë realizuar një sërë aktivitete të orientuara drejt parandalimit të krimit. Kjo ka përfshirë fushata ndërgjegjësimi, veçanërisht në mes të nxënësve, për të trajtuar fenomene të dëmshme, si abuzimi me drogën, bullizmi dhe dhuna në familje.

Duke përmbledhur aktivitetet dhe arritjet e vitit 2024, Policia e Kosovës ka bërë hapa të mëdhenj përpara, duke garantuar një ambient më të sigurt dhe më të drejtë për qytetarët. Megjithatë, sfidat e mëdha mbeten përpara dhe ne do të vazhdojmë të angazhohemi me përkushtim për të mbrojtur rendin dhe sigurinë e çdo qytetari të Kosovës.

Në aspektin e ngritjes së kapaciteteve në fushën e burimeve njerëzore, gjatë këtij viti, janë punësuar 1,374 zyrtarë policorë të rinj të Policisë. Për të siguruar një forcë policore të shëndetshme dhe të aftë për të përballuar sfidat e përditshme, Policia e Kosovës ka vazhduar bashkëpunimin me Shërbimin Spitalor të Klinikës Universitare, për të ofruar mbështetje mjekësore dhe psikologjike për punonjësit. Gjatë vitit 2024 janë realizuar më shumë se 3,000 ekzaminime mjekësore dhe psikologjike, duke garantuar mirëqenien e stafit policor.

Në fund, falënderoj çdo punonjës të Policisë së Kosovës për përkushtimin dhe sakrificat e bëra gjatë këtij viti. Po ashtu, falënderoj qytetarët e Kosovës për mbështetjen e vazhdueshme dhe besimin që kanë treguar ndaj Policisë. Me angazhimin tonë të përbashkët, ne do të vazhdojmë të punojmë për një të ardhme më të sigurt për të gjithë.

Përmbledhje ekzekutive

Në Policinë e Kosovës janë të punësuar 9,886 punonjës, prej të cilëve 9,046 janë zyrtarë policorë, ndërsa 840 staf civil. 84.62% e personelit të Policisë i takojnë gjinisë mashkullore, ndërsa 15.37% gjinisë femërore, prej të cilëve 89.92% janë shqiptarë, ndërsa 10.07% iu takojnë komuniteteve të tjera.

- Numri i vrasjeve ka shënuar rënie për 41.37%;
- Numri i lëndimeve të rënda trupore ka shënuar rënie për 7.23%;
- Numri i vjedhjeve të rënda ka shënuar rënie, për 21.07%;
- Numri i rasteve të dhunës në familje ka shënuar ngritje, për 3.53%.

Për të adresuar sfidat në trafikun rrugor, Policia ka hartuar dhe zbatuar 17 plane operacionale në fusha kyçe që synojnë përmirësimin e sigurisë rrugore dhe reduktimin e aksidenteve. Po ashtu ka përgatitur 90 fushata vetëdijesuese/aktivitete, të cilat kanë qenë të fokusuara në ngritjen e sigurisë në trafikun rrugor.

Me synimin e identifikimit të hershëm të sëmundjes dhe ofrimit të mbështetjes mjekësore dhe psikologjike për punonjësit e Policisë, është nënshkruar vazhdimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të Policisë së Republikës së Kosovës dhe Shërbimit Spitalor të Klinikës Universitare të Kosovës për Shërbim Mjekësor dhe Psikologjik të personelit policor dhe rekrutëve.

Policia ka përgatitur projektpropozimin për themelimin e "Qendrës diagnostikuese specialiste për kontrollim mjekësor për personelin policor të Policisë së Kosovës". Kjo qendër do të ofrojë shërbime të plota mjekësore për personelin policor dhe rekrutët në Policinë e Kosovës, duke u fokusuar në ofrimin e kontrolleve të rregullta mjekësore dhe specialiste, duke përmirësuar cilësinë e kujdesit shëndetësor, diagnostikimin e hershëm të sëmundjeve, trajtimin dhe kujdesin për rehabilitim duke u përshtatur në mënyrë specifike për sfidat unike të shëndetit fizik dhe mendor me të cilat përballen punonjësit e zbatimit të ligjit.

Në kuadër të aktiviteteve policore të orientuara në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, krimeve të rënda, krimit ekonomik dhe korrupsionit, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, është punuar në gjithsej 1,471 raste. Janë:

- realizuar 274 operacione;
- arrestuar 1,148 persona të dyshuar për vepra të rënda penale, ndërsa janë ndaluar 560 persona;
- bastisur&kontrolluar 770 lokale;
- paraqitur 965 kallëzime penale me kryes të njohur, ndaj 1,715 personave; si dhe janë
- goditur 28 grupe kriminale.

Për të rritur sigurinë në komunitet dhe në përputhje me Strategjinë e Integruar të Policimit, të udhëhequr nga Inteligjenca dhe Policimit në Bashkësi, si dhe me Planin e Veprimit 2021-2025, Policia ka vazhduar angazhimin e saj për nxitjen dhe forcimin e partneriteteve me komunitetin. Kjo është arritur përmes një game të gjerë projektesh dhe aktivitetsesh që synojnë parandalimin e krimit dhe promovimin e sigurisë publike. Një fokus kryesor ka qenë në zbatimin e iniciativave që synojnë ndërgjegjësimin dhe këshillimin, veçanërisht mes nxënësve, për të trajtuar fenomene negative në shoqëri si abuzimi me drogën, bullizmi, dhuna në familje, etj.

Përveç kësaj, Policia është angazhuar në programe të ndryshme të komunikimit me komunitetin, duke punuar ngushtë me shkollat, organizatat lokale dhe banorët për të trajtuar krimin në mënyrë proaktive. Këto përpjekje janë krijuar për të krijuar besim, për të fuqizuar komunitetin dhe për të siguruar mjedise më të sigurta për të gjithë.

Me prioritet të lartë është shpallur konkursi publik për zyrtarë policorë vetëm për minoritete (vendi i punës Mitrovicë Veri). Si rezultat i këtij konkursi gjatë vitit 2024 është rritur numri i zyrtarëve policorë në DRP Mitrovicë Veri në krahasim me vitin 2023 për 30.35%. Ky numër do të rritet me diplomimin e 117 kadetëve të gjeneratës së 61-të që do të jetë 452 zyrtarë policorë të punësuar në DRP Mitrovicë Veri apo 75.87% më shumë se në vitin 2023.

Me qëllim të ofrimit të sigurisë së kufijve, janë ndërmarrë: 54 operacione, 431 patrullime të përbashkëta, janë realizuar 94 aktivitete të bashkëpunimit ndërkombëtar, 3,166 refuzime të hyrjes dhe 648 refuzime të daljes nga Republika e Kosovës. Janë shqiptuar 1,054 gjoba për kundërvajtje në fushën e migrimit dhe të huajve.

Në vitin 2024, policia vazhdoi të forconte bashkëpunimin e saj me mediat për të rritur ndërgjegjësimin për çështjet e sigurisë publike dhe për të nxitur besimin e komunitetit. Janë lëshuar:

- 593 komunikata me shkrim për media;
- 366 raporte 24-orëshe;
- 1,787 aktivitete të ndryshme policore në rrjetet sociale të Policisë.

Përmbledhje ekzekutive



Raste

Viti 2023	●	Viti 2024
50,564		48,615



Vepra penale

Viti 2023	●	Viti 2024
28,827		27,865



Persona të arrestuar

Viti 2023	●	Viti 2024
15,072		15,297



Persona të ndaluar

Viti 2023	●	Viti 2024
5,297		6,002



Grupe kriminale të goditura

Viti 2023	●	Viti 2024
34		28



Armë zjarri të konfiskuara

Viti 2023	●	Viti 2024
1,392		1,746



Municione të konfiskuara

Viti 2023	●	Viti 2024
37,215		33,250



Persona të vdekur në trafikun rrugor

Viti 2023	●	Viti 2024
106		97



Tiketa të shqiptuara në trafikun rrugor

Viti 2023	●	Viti 2024
648,646		724,485



Gjopa për kundërvajtje në fushën e migrimit

Viti 2023	●	Viti 2024
1,191		1,054



Aksidente në trafikun rrugor

Viti 2023	●	Viti 2024
23,676		22,604



Hyrje/dalje të personave në kufi

Viti 2023	●	Viti 2024
27,301,856		30,503,299



Protesta dhe tubime të qytetarëve

Viti 2023	●	Viti 2024
728		477



Refuzimi i hyrjes në Republikën e Kosovës

Viti 2023	●	Viti 2024
3,432		3,166



Refuzimi i daljes nga Republika e Kosovës

Viti 2023	●	Viti 2024
636		648

Siguria, rendi dhe qetësia publike

Policia, si institucion i zbatimit të ligjit, ka arritur sukses të konsiderueshëm në parandalimin dhe luftimin e krimit si dhe rritjen e bashkëpunimit efektiv me qytetarët, bashkëpunimit ndërinstitucional dhe partneriteteve ndërkombëtare. Pavarësisht përballjes me sfida të shumta, Policia mbetet e përkushtuar ndaj rolit të saj në ruajtjen e sigurisë publike, zbatimin e ligjit dhe mbrojtjen e komuniteteve.

Gjatë periudhës raportuese, Policia e Kosovës ka evidentuar gjithsej **48,615** raste, prej të cilave **27,865** janë klasifikuar si vepra penale, ndërsa **20,750** raste janë klasifikuar si kundërvajtje dhe raste të natyrave të tjera. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023, numri i rasteve ka shënuar *rënie* për **3.85%**, po ashtu numri i veprave penale ka shënuar *rënie* për **3.33%**. Numri i kundërvajtjeve dhe raste të natyrave të tjera kanë shënuar *rënie* për **4.54%**.



Rëniet/ngritjet më të dalluara janë vërejtur si në vijim:

- Numri i vrasjeve ka shënuar *rënie*, nga **29** në **17** ose *rënie* për **41.37%**;
- Numri i lëndimeve të rënda trupore ka shënuar *rënie*, nga **235** në **218**, ose *rënie* për **7.23%**;
- Numri i vjedhjeve ka shënuar *rënie*, nga **4,164**, në **3,696**, ose *rënie* për **11.23%**;
- Numri i vjedhjeve të rënda ka shënuar *rënie*, nga **2,747** në **2,168**, ose *rënie* për **21.07%**;
- Numri i grabitjeve ka shënuar *rënie*, nga **93** në **72**, ose *rënie* për **22.58%**;
- Numri i rasteve të dhunës në familje ka shënuar *ngritje*, nga **2,460** në **2,547**, ose *ngritje* për **3.53%**.

Gjatë kësaj periudhe si rezultat i angazhimit policor janë ndaluar **6,002** persona, për shkak të dyshimeve në përfshirje në akte kriminale, ku në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2023 është shënuar një *ngritje* për **13.30%**. Po ashtu, Policia ka arrestuar **15,297** persona, të cilët në bashkëpunim me autoritetet përkatëse janë dërguar në procedura të mëtejme. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, vërehet një *ngritje* e personave të arrestuar për **1.49%**.

Në operatione të ndryshme të ndërmarra, Policia ka konfiskuar **1,746** armë zjarri të llojeve të ndryshme dhe në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2023 është shënuar një *ngritje* për **25.43%**, si dhe janë konfiskuar **33,250** sasi të municionit të kalibrave të ndryshëm dhe në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2023 është shënuar një *rënie* për **10.65%**.

Gjatë kësaj periudhe, Policia ka regjistruar gjithsej **477** protesta dhe tubime, në të cilat Policia e Kosovës ka kryer një varg të detyrave policore lidhur me këto protesta dhe tubime. Në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2023 vërehet një *rënie* e protestave dhe tubimeve për **34.47%**.

Përveç angazhimit policor në përmbushjen e objektivave strategjike të Policisë të parapara për vitin 2024, gjatë kësaj periudhe, Policia ka ofruar mbështetjen e saj të vazhdueshme dhe autoriteteve tjera relevante në përmbushjen e detyrave të tyre të përcaktuara me ligj, me ç'rast janë ofruar **7,583** asistime. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, vërehet një *ngritje* e ofrimit të asistencës për **6.30%**.



Departamenti për Inteligjencë dhe Analizë ka mbledhur me sukses të dhëna thelbësore gjatë kësaj periudhe dhe ka shpërndarë raporte gjithëpërfshirëse për njësitë relevante.

Tabela.nr1: Aktivitet i DIA-s

Aktivitetet e DIA-s	2023	2024	%
Informata të inteligjencës	8950	10,689	19.43
Raporte të shpërndara	3212	2,687	-16.34
Raporte analitike	71	76	7.04
Raporte mbi situatën e sigurisë	205	215	4.87

Mbështetja nga Njësitë Speciale:

Departamenti i Njërive Speciale ka kryer operacione të shumta mbështetëse krahas njërive të ndryshme, duke u angazhuar në aktivitete me rrezik të lartë dhe të mesëm që lidhen me krimet e rënda, terrorizmin, mbrojtjen e rendit kushtetues dhe mbrojtjen e përgjithshme të sigurisë.

Tabela nr.2: Aktivitetet e Departamentit të Njërive Speciale

Lloji i aktiviteteve Operative	Krahasimi sipas viteve		
	2023	2024	%
Urdhër operativ	60	84	40
Plane operative nga DNJS	43	314	630.2
Plane Taktike	0	155	100
Asistim gjykatave	1	3	200
Asistim SHKK-së	69	35	-49.28
Asistim agjencioneve tjera (DBNP etj.)	5	1	-80
Numri i operacioneve me agjencione tjera	84	29	-65.48
Menaxhimi i protestave	9	3	-66.67
Angazhim (divizioni, njësia DRP)	593	576	-2.87
Gjendje gatishmërie	1003	1041	3.79
Pika statike	108	129	19.44
Subs. narkotike të gjetura	19	13	-31.58
Hapësira dhe rrugë të kontrolluara	727	1246	71.39
Objekte të kontrolluara	545	705	29.36
Automjete të kontrolluara	11727	14167	20.81
Persona të prangosur	18	21	16.67
Persona të kontrolluar	11780	11332	-3.8
Municion i gjetur	38	40	5.26

Tabela nr.3: Aktivitetet e Departamentit të Njërive Speciale

Lloji i aktiviteteve Operative	Krahasimi sipas viteve		
	2023	2024	%
Patrullim sigurim në Kampin Vrellë	761	590	-22.47
Punë sekondare BQK	99	79	-20.2
Asistim DHKOKR	67	38	-43.28
Asistim DMA-së	16	12	-25
Asistim FIST	3	1	-66.67
Asistim Policisë Kufitare	119	3	-97.48
Pika kontrolli	2172	2011	-7.41
Patrullim në këmbë dhe mobile	1360	1492	9.71
Përcjellje të VIP-së	0	1	100
Asistim NJHR-së	1	1	0
Asistim DHTN-së	1	1	0
Asistim DHKEK-së	4	3	-25
Asistim DRP Prishtinë	336	206	-38.69
Asistim DRP Gjakovë	5	4	-20
Asistim DRP Mitrovicë	434	341	-21.43
Asistim DRP Pejë	2	9	350
Asistim DRP Prizren	7	11	57.14
Asistim DRP Ferizaj	6	2	-66.67

Armë të gjetura	29	13	-55.17
Gjetje e mjeteve të dyshuara shpërthyesë – neutralizim	24	40	66.67
Hetim pas shpërthimit	16	21	31.25
Çmontim i mjeteve shpërthyesë	4	1	-75
Angazhimi ndaj kërcënimeve me bombë	10	2	-80
Inspektive	11	168	1427.2

Asistim DRP Gjilan	4	6	50
Gjurmim, kërkim i personave të dyshuar ose të humbur	18	14	-22.22
Vlerësimi i rrezikshmërisë për personat me rëndësi të veçantë	19	22	15.79

Tabela nr.4: Aktivitetet e Departamentit të Njësisë Speciale

Aktivitetet operative	Krahasimi sipas viteve		
	2023	2024	%
Rivlerësimi i rrezikshmërisë për personat me rëndësi të veçantë	9	5	-44.44
Vlerësimi i rrezikshmërisë për objektet me rëndësi të veçantë	3	5	66.67
Rivlerësimi i rrezikshmërisë për objektet me rëndësi të veçantë	0	8	100
Vlerësimi i rrezikshmërisë për delegacionet e huaja	21	26	23.81
Vlerësimi i rrezikshmërisë për policë	1	7	600.00
Vlerësimi i rrezikshmërisë për gazetarë	0	1	100
Vlerësimi i rrezikshmërisë për dëshmitarë të mbrojtur	2	1	-50.00
Kontaktet 4 mujore lidhur me sigurinë për ambasadat dhe zyret ndërlidhëse diplomatike të huaja	3	18	500.00
Vlerësimi i rrezikshmërisë për vendbanimin e dëshmitarëve bashkëpunues	0	1	100
Vlerësimi i rrezikshmërisë për dëshmitarë bashkëpunues	0	1	100
Vlerësimi i rrezikshmërisë për gardianë në shërbimin korrektues	0	1	100
Operacion i veçantë	82	68	-17.07
Ekstradimi	52	49	-5.77
Operacion rutinë përcjellje e VIP vendor	29	20	-31.03
Totali	32559	34896	7.18

Policia e Kosovës vazhdon të mbajë bashkëpunim të fuqishëm ndërkombëtar me shtetet, për të rritur efektivitetin e saj në luftimin e krimit, garantimin e sigurisë dhe promovimin e stabilitetit rajonal.

Tabela nr.5: Komunikimi sipas kategorive të autoriteteve/kanaleve zyrtare

Autoriteti/Kanali i komunikimit	2023	2024	Ndryshimi	%
NCB-INTERPOL	5007	5847	840	16.77
SIENA-EUROPOL	1658	3236	1578	95.17
Ndërlidhësit tanë policorë jashtë vendit	1112	1263	151	13.57
Ndërlidhësit policorë të huaj	1024	1623	599	58.49
Organizatrat ndërkombëtare tjera	8573	5001	3572	-41.66
Ambasadat e Kosovës jashtë	1209	1536	327	27.04
Ambasadat e huaja në Kosovë	1000	1007	7	0.7
Bashkëpunimi ndërinstitucional brenda	5715	8665	2950	51.61
Policia e Kosovës/DBNP	18228	21675	3447	18.91

Siguria në trafikun rrugor

Siguria në trafikun rrugor mbetet një sfidë për Policinë për shkak të faktorëve si tejkalimi i shpejtësisë, drejtimi i shpërqendruar dhe mosrespektimi i ligjeve të trafikut. Policia vazhdimisht synon rritjen e sigurisë në trafik që është thelbësore për reduktimin e aksidenteve, lëndimeve dhe vdekjeve në rrugë. Aktivitetet e tilla si fushatat e ndërgjegjësimit të publikut, programet e edukimit për sigurinë në trafik në shkolla dhe komunitete, zbatimi i ligjit të trafikut ndihmojnë në promovimin e sjelljeve të përgjegjshme të drejtimit të automjeteve dhe inkurajojnë respektimin e rregullave të sigurisë. Policia, gjithashtu bashkëpunon me agjenci të tjera për të reduktuar rreziqet që lidhen me trafikun rrugor dhe përmirësimin e sigurisë së përgjithshme rrugore.



Për të adresuar sfidat në trafikun rrugor, Policia ka hartuar dhe zbatuar **17** plane operacionale në fusha kyçe që synojnë përmirësimin e sigurisë rrugore dhe reduktimin e aksidenteve. Po ashtu janë hartuar **119** raporte analitike dhe janë realizuar **64** inspektime të infrastrukturës rrugore, të cilat kanë qenë të orientuara në vlerësimin e gjendjes dhe projektimit të rrugëve për të identifikuar rreziqet që kontribuojnë në aksidente. Ka hartuar **57** raporte/shkresa për MMPHI dhe Komuna në lidhje me gjendjen e infrastrukturës rrugore si dhe **230** shkresa të ndryshme për sigurinë në trafikun rrugor, të cilat janë adresuar tek institucionet përkatëse.

Janë realizuar **71** intervista për media dhe janë publikuar **90** fushata vetëdijesuese/aktivitete, të cilat kanë qenë të fokusuar në ngritjen e sigurisë në trafikun rrugor. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar **679** përcjellje të materieve të rrezikshme dhe **521** përcjellje të personaliteteve të rëndësishëm.



Pavarësisht sfidave në trafikun rrugor, Policia ka arritur të reduktojë aksidentet në përgjithësi përmes planeve strategjike operacionale dhe duke i mbajtur përgjegjës kundërvajtësit për shkeljen e ligjit të trafikut. Gjatë këtij viti janë shqiptuar **724,485** tiketa për kundërvajtje në trafikun rrugor, që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, tregon një *ngritje* të shqiptimit të tiketave për **11.69%**, ndërsa *rënie* të aksidenteve në trafikun rrugor:

- aksidenteve në trafikun rrugor, nga **23,676** në **22,604** aksidente, apo *rënie* për **4.52%**;
- aksidenteve me fatalitet, nga **96** në **89** aksidente, apo *rënie* për **7.29 %**;
- aksidenteve me lëndime, nga **8,764** në **8,147** aksidente, apo *rënie* për **7.04%**;
- aksidenteve me dëme materiale, nga **14,817** në **14,368** aksidente, apo *rënie* për **3.03%**;
- **97** persona kanë humbur jetën, që në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2023 shënon *rënie* për **8.49%**;
- **15,289** persona janë lënduar, që në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2023 shënon *rënie* për **9.55%**.

Sa iu përket aktiviteteve të Komisionit për Vendosije, lidhur me kundërshtime të parashtruara për kundërvajtjet e shqiptuara nga ana e Policisë, gjatë këtij viti janë pranuar gjithsej **9,672** kundërshtime (ankesa), janë mbajtur gjithsej **965** seanca për shqyrtimin e kundërshtimeve dhe janë përpiluar gjithsej **8,984** vendime.

Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar, krimeve të rënda, krimit ekonomik dhe korrupsionit, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit

Për periudhën raportuese, në kuadër të aktiviteteve policore të orientuara në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, krimeve të rënda, krimit ekonomik dhe korrupsionit, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, është punuar në gjithsej **1,471** raste, prej tyre **879** raste të reja, **277** raste të pranuar nga njësitë e tjera në kuadër të Policisë së Kosovës, **315** raste janë bartur nga vitet paraprake. Sa i përket krahasimit të numrit të rasteve në punë me vitin 2023 tregon *rënie* për **10.95%**.



Janë realizuar **274** operacione, që krahasuar me vitin 2023 tregon *rënie* për **0.14%** dhe janë bastisur dhe janë kontrolluar **770** lokale, që në krahasim me vitin 2023 tregon *rënie* për **12.59%**.

Gjatë vitit 2024 janë arrestuar **1,148** persona të dyshuar për vepra të rënda penale, që krahasuar me vitin 2023 tregon *rënie* për **18.17%**, ndërsa janë ndaluar **560** persona, që krahasuar me vitin 2023 tregon *rënie* për **4.76%**.

Janë paraqitur **1,032** kallëzime penale, **67** prej të cilave me kryes të panjohur, **965** kallëzime penale me kryes të njohur ndaj **1,715** personave, krahasuar me vitin 2023 kemi një *rënie të kallëzimeve penale* për **12.83%**. Janë goditur **28** grupe kriminale që krahasuar me vitin 2023 tregon *rënie* për **12.82%**.

Në fushën e luftimit të trafikimit me qenie njerëzore, gjatë vitit 2024 janë regjistruar **118** raste, janë arrestuar **160** persona të dyshuar dhe janë paraqitur **37** kallëzime penale ndaj **56** personave të dyshuar dhe **53** fletëparaqitje për kundërvajtje ndaj **105** personave. Prej tyre, për: a) trafikim me njerëz - janë regjistruar **8** raste; b) mundësim prostitucioni - janë iniciuar **27** raste; c) marrje me prostitucion - janë regjistruar **46** raste dhe d) për vepra të tjera të kësaj natyre - janë regjistruar **37** raste. Janë identifikuar **16** viktimat të trafikimit, dhe janë asistuar **68** viktimat.

Në fushën e parandalimit, hetimit dhe zbulimit të trafikimit me narkotikë janë iniciuar gjithsej **567** raste të reja, janë arrestuar **705** persona dhe janë paraqitur **532** kallëzime penale ndaj **735** të dyshuarve. Prej tyre, për: a) trafikim - janë regjistruar **201** raste, b) posedim të drogave - **340** raste, c) kultivim **22** raste dhe d) për vepra të tjera të kësaj natyre - **4** raste. Nga numri i përgjithshëm i rasteve, për heroinë janë iniciuar **10** raste për kokainë janë regjistruar **59** raste, për marihuanë janë iniciuar **455** raste, për kultivimin e bimëve të kanabisit janë iniciuar **23** raste ndërsa për droga të tjera janë regjistruar **18** raste.

Gjatë vitit 2024 janë konfiskuar **27 kg. 883.94 gr.** heroinë; **14 kg 099.32 gr.** kokainë; **1279 kg 844.85 gr.** Marihuanë si dhe **7,126** bimë kanabis.

Në fushën e luftimit kundër krimeve ekonomike dhe korrupsionit janë regjistruar **289** raste, janë arrestuar **106** të dyshuar dhe janë paraqitur **276** kallëzime penale ndaj **557** personave të dyshuar. Për veprën penale: a) kundër detyrës zyrtare/korrupsionit- janë regjistruar **118** raste; b) kundër ekonomisë - **23** raste; c) kundër pasurisë- **51** raste; d) falsifikim dhe mashtrim - **58** raste; e) shpëlarje të parave- **2** raste; dhe e) vepra të tjera janë regjistruar **37** raste.

Në fushën e hetimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda janë iniciuar **105** raste, arrestuar **87** persona të dyshuar dhe ka ngritur **60** kallëzime penale ndaj **125** të dyshuarve. Për veprën penale: a) krim i organizuar- është regjistruar **1** rast; b) kontrabandim me armë - **8** raste; c) vrasje – **1** rast; d) fajde - **7** raste; e) auto krime - **4** raste dhe f) kanosje - **34** raste; g) detyrim - **4** raste; i) organizim i skemave piramidale – **1** rast; dhe j) për vepra tjera të kësaj natyre janë regjistruar **45** raste.

Në fushën e parandalimit dhe luftimit të terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit - janë regjistruar **23** raste, janë arrestuar **14** persona të dyshuar dhe janë paraqitur **7** kallëzime penale ndaj **16** personave të dyshuar. Prej gjithsej **32** rasteve **5** janë regjistruar në fushën e terrorizmit dhe **18** për vepra tjera.

Në fushën e hetimit të Krimeve Kibernetike ka regjistruar **34** raste, janë arrestuar **67** persona të dyshuar dhe janë ngritur **36** kallëzime penale ndaj **79** personave të dyshuar.

Hetimi i krimeve të luftës janë iniciuar **15** raste, ka arrestuar **9** persona dhe ka përcjellë **15** kallëzime penale ndaj **139** personave.

Njësia e Veçantë e Hetimeve ka iniciuar **5** raste kundër detyrës zyrtare dhe ka përcjellë **2** kallëzime penale ndaj **8** të dyshuarve.



*Tabela nr.7: Veprat penale-
Departamenti i Hetimeve*

Vepra penale	2023	2024	%
Trafikim me narkotikë	218	201	-7.79
Trafikim me njerëz	17	8	-52.94
Kundër ekonomisë	59	23	-61.01
Korrupsion	147	118	-19.72
Fajde	9	7	-22.22
Shpëlarje e parave	6	2	-66.66
Krim i organizuar	3	1	-66.66
Veprat tjera të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda	121	104	-14.04
Kontrabandim me armë	6	8	33.33
Krime kibernetike	40	34	-15
Terrorizëm	18	5	-72.22
Raste tjera të fushës së terrorizmit	14	18	28.57
Krime lufte	14	15	7.14

Tabela nr.8: Aktivitetet e Departamentit të Hetimeve

Kategoria	2023	2024	%
Operacione policore	323	274	-0.14
Bastisje/lokale të kontrolluara	881	770	-12.59
Grupe kriminale	34	28	-17.64
Kallëzime penale	1107	965	-12.82

Tabela nr.9: Asetet e ngrira/Sekuestruara

ASETET E NGRIRA/ SEKUESTRUARA	2023	2024	%
Shtëpi	2	1	-50%
Banesa	11	66	500%
Lokale	7	4	-42.80%
Garazhe	8	30	275%
Patundshmëri (toka)	182	29	-84%
Ngrirje e xhirollogarive	2	13	550%
Ari	931.56g	33 kg 406.05g	3486%
Vlera e përafërt e aseteve	20,435,030.80 €	10,045,609.94 €	-50.80%

Tabela nr.10: Konfiskimet/sekuestrimet

KONFISKIME/SEKUESTRIME	2023	2024	%
Substancë narkotike (HEROINË)	2kg 872.05g	27kg 883.94g	870.87%
Substancë narkotike (KOKAINË)	5kg 466.86g	14kg 099.32g	157.91%
Substancë narkotike (MARIHUANË)	601kg 113.45g	1279kg 844.85g	112.91%
Extasy (gram)	1kg 258.28g	3kg 791.2g	201.30%
Amphetamin/Methamph.-Speed (gram)	0	415.99g	100.00%
Substanca narkotike (bimë kanabisi)	21,989	7,126	-67.59%
Substanca Narkotike (fara kanabisi - gram)	45kg 007.04g	26.5g	-100.00%
Substanca tjera	6kg 620.01g	362kg 090.51g	5369.64%
Armë	127	109	-14.17%
Municion	15082	5543	-63.25%
Euro	531,231,82	2,534,004.57	377.01%
Dollar	3445	148,236	4202.93%
Franga- CHF	2,290	34,420	1403.06%
Lekë	125,300	10,650	-91.50%
Vetura	107	117	9.35%

Kontrolli, mbikëqyrja dhe menaxhimi i integruar i kufirit

Policia është e përkushtuar për të mbrojtur kufijtë e vendit kundër një sërë kërcënimesh, duke përfshirë emigracionin e paligjshëm, trafikimin e qenieve njerëzore, kontrabandën e drogës dhe armëve si dhe terrorizmin. Roli i Policisë në kontrollin kufitar është i shumëanshëm, duke përfshirë jo vetëm patrullimet dhe kontrollet fizike, por edhe mbledhjen e inteligjencës, vlerësimin e rrezikut dhe zbatimin e strategjive proaktive për parandalimin e krimit. Policia punon ngushtë me doganat dhe agjenci të tjera për të monitoruar dhe siguruar kufijtë dhe për të parandaluar aktivitetet e paligjshme.

Si rezultat i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve të autoriteteve të MIK-ut, kufijtë e Republikës së Kosovës i kanë kaluar **30,503,299** persona, që krahasuar me vitin e kaluar tregon *ngritje* për **11.72%**; **8,823,558** mjetet motorike, që tregon *ngritje* për **11.86%** krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa *rënie* për **100%** e trenave.

Tabela nr.11: Kontrolli dhe mbikëqyrja e kufirit

Kategoria	2023	2024	%
Hyrje/dalje të personave në kufi	27,301,856	30,503,299	11.72
Mjete motorike të kaluar në kufi	7,887,764	8,823,558	11.86
Refuzim të hyrjes në RKS	3,432	3,166	-7.75
Refuzim të daljes nga RKS	636	648	1.88
Gjopa për kundërvajtje në fushën e migrimit dhe të huajve	1,191	1,054	-11.5
Persona të kontrolluar në vijën e dytë	37,341	35,941	-3.74

Në kuadër të kontrollit të hyrje-daljeve të personave në pikat kufitare janë evidentuar dhe janë procesuar **9,461** persona të rëndësishëm (VIP).



Gjatë ofrimit të sigurisë së kufijve të Republikës së Kosovës, si rezultat i shkeljeve të ndryshme ligjore, pjesëtarët e Policisë së Kosovës kanë hapur **520** raste të veprave penale, **246** kundërvajtje, kanë shqiptuar **1,054** gjopa për kundërvajtje në fushën e migrimit dhe të huajve. Policia Kufitare ka arrestuar **589** persona për vepra të ndryshme kriminale, **1,939** persona me urdhëresa vendore dhe ka ndaluar **13** persona.

Tabela nr. 12: Aktivitetet e Policisë Kufitare

Kategoritë	2023	2024	%
Rastet e trajtuara në total	548	520	-5.11%
Kundërvajtjet	238	246	3.36%
Personat e arrestuar	593	589	-0.67%
Personat e arrestuar me urdhëresë	1571	1939	23.42%
Armë zjarri të konfiskuara	30	100	233.33%
Municion (copë)	1063	3707	246.77%

Me qëllim të përmbushjes së objektivave të parapara për periudhën raportuese, zyrtarët e Policisë Kufitare kanë bërë **1,160** inspektime në fushën e migrimit të të huajve, **3,166** refuzime të hyrjes, **648** refuzime të daljes, si dhe kanë realizuar **2,589** verifikime të kërkesave për viza të Republikës së Kosovës. Po ashtu, zyrtarët e Policisë Kufitare kanë ekzekutuar **39** depërtime, **36** urdhër largime me forcë, **454** urdhër largime vullnetare dhe kanë trajtuar **188** kërkesa për azilkërkues.




Tabela nr.13: Aktivitetet në bazë të Ligjit për të huaj

Aktivitetet	2023	2024	%
Inspektime	1097	1160	5.74
Depërtime të ekzekutuara me vendim gjykate	11	39	254.54
Vendime për largim me forcë	24	36	50
Vendime për largime vullnetare	189	454	140.21
Azilkërkues	179	188	5.02
Vërtetim për akomodim në Qendrën e pritjes në Vranidoll	471	853	81.1

Policia Kufitare gjatë kësaj periudhe ka realizuar **54** operacione dhe **431** patrullime të përbashkëta me shtetet fqinje (Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi). Sa i përket menaxhimit të integruar të kufirit janë realizuar: **67** takime të punës brenda Policisë, **49** takime me autoritetet e MIK-ut, ndërsa **94** aktivitete kanë qenë me karakter ndërkombëtar.

Tabela nr.14: Rastet në bazë të Ligjit për të Huaj

Rastet	2023	2024	%
Qëndrim i paligjshëm	48	216	350
Gjoha të shqiptuara për kompani	93	90	-3.22
Shtetas të trajtuar me aplikacion për mbrojtje të përkohshme-refugjat	12	67	458.33

Tabela nr.15: Aktivitete me rëndësi në kuadër të DPK

Veprat penale sipas kompetencës	2023	2024	%
Kalim i paaautorizuar i kufirit	115	125	8.69
Kontrabandë me emigrantë	11	11	0
Posedim i paligjshëm i armëve	41	68	65.85
Kontrabandë me mallra	89	61	-31.46
Falsifikimi i dokumentit	39	26	-33.33

Gjatë vitit 2024 Policia Kufitare, në bashkëpunim me autoritet e Shqipërisë dhe EUROPOL-in ka trajtuar rastin e koduar „MODIFIKIMI”, ku në dy shtetet janë arrestuar 24 persona dhe janë konfiskuar 64 armë të vogla dhe të gjata. Të dhënat tregojnë se në këtë rast është shkatërruar një grup kriminal i cila ka vepruar së paku në dy shtete.



Burimet njerëzore

Policia e Kosovës, aktualisht përbëhet nga **9,886** punonjës, prej të cilëve **9,046** janë zyrtarë policorë, ndërsa **840** staf civil. Nga ky numër **84.62%** e personelit të Policisë i takojnë gjinisë mashkullore, ndërsa **15.37%** gjinisë femërore, prej të cilëve **89.92%** janë shqiptarë, ndërsa **10.07%** iu takojnë komuniteteve tjera.

Tabela nr.16: Krahاسimi i përfaqësimit Polici/Popullsi

Krahاسimi i përfaqësimit Polici/Popullsi	Shqiptarë	Serbë	Boshnjakë	Turq	Romë	Ashkali nj	Egjiptianë	Goranë	Të tjerë	Totali i popullsisë dhe i të punësuarve në Polici për vitin 2024
Popullsi	1454999	53021	27152	19419	8730	16207	10581	9140	3266	1602515
Të punësuar në Polici gjatë vitit 2024	8019	525	224	81	19	27	24	35	7	8961
Totali i % në popullatë	90.79%	3.31%	1.69%	1.21%	0.54%	1.01%	0.66%	0.57%	0.20%	
Totali i % në Polici	89.49%	5.86%	2.50%	0.90%	0.21%	0.30%	0.27%	0.39%	0.08%	
Diferenca	-1.31%	2.55%	0.81%	-0.31%	-0.33%	-0.71%	-0.39%	-0.18%	-0.13%	

Vazhdimësia e policisë është thelbësore për ruajtjen e një sistemi të qëndrueshëm, efektiv dhe profesional të zbatimit të ligjit. Policia është e përkushtuar për të garantuar suksesin e saj afatgjatë dhe efikasitetin operacional duke investuar vazhdimisht në personelin dhe infrastrukturën e saj.

Gjithsej, gjatë këtij viti janë punësuar **1,374** zyrtarë, prej tyre **1,122** meshkuj dhe **252** femra, 221.78% më shumë se në vitin 2023.

Tabela nr.17: Krahاسimi i të punësuarve në PK për 2023/2024

Të punësuar	Viti 2023			Viti 2024			Krahاسim %
Etniciteti	Civil	Uniformë	Gjithsej	Civil	Uniformë	Gjithsej	
Shqiptar	11	341	352	27	1158	1185	236.64
Serb	0	51	51	1	120	121	137.25
Boshnjak	0	20	20	0	53	53	165
Turk	0	5	5	0	15	15	200
Egjiptian	0	4	4	0	14	14	250
Ashkali	0	3	3	0	9	9	200
Romë	0	2	2	0	5	5	150
Goran	0	1	1	0	0	0	
Gjithsej	11	427	438	28	1374	1402	220.09%

Me prioritet të lartë është shpallur konkursi publik për zyrtarë policorë vetëm për minoritete (vendi i punës Mitrovicë Veri). Nga ky konkurs në gjeneratën e 61-të janë punësuar **118** kadetë policorë, prej tyre **91** meshkuj dhe **27** femra.

Si rezultat i zhvillimit të konkursit vetëm për minoritete është rritur numri i zyrtarëve policorë në DRP Mitrovicë Veri në krahasim me vitin 2023, derisa në vitin 2023 për 30.35%.

Ky numër do të rritet me diplomimin e **117** kadetëve të gjeneratës së 61-të, që do të jetë **452** zyrtarë policorë të punësuar në DRP Mitrovicë Veri, apo 75.87% më shumë se në vitin 2023.

Tabela nr.18: Ndryshimet e personelit

Kategoria	2023		Gjithsej	2024		Gjithsej	%
	Zyrtarë policorë	Staf civil		Zyrtarë policorë	Staf civil		
Dorëheqjet	94	13	107	88	8	96	-10.3
Pensionimi	146	32	178	135	19	154	-13.5
Vdekjet	24	2	26	22	3	25	-3.85
Ndërprerje e marrëdhënies së punës	29	3	32	21	1	22	-31.3
TOTALI	293	50	343	266	31	297	-13.41

Pasi që gradimi i punonjësve të Policisë është i rëndësishëm për sigurimin e një hierarkie të qartë, përgjegjësie dhe përparimi në karrierë brenda Policisë, Sektori për Zhvillim të performancës ka bërë përgatitjet për proceset e gradimit për gradën Rreshter dhe në muajin shkurt është shpallur konkursi për procesin e gradimit për këtë gradë. Në këtë proces kanë aplikuar **2,343** kandidatë, të cilët i janë nënshtruar testimit me shkrim. Pas shprehjes së disa pakënaqësive nga një numër i kandidatëve në këtë proces, Policia duke u bazuar në parimet e transparencës, etikës, vlerave themelore, integritetit profesional dhe besueshmërisë, ka angazhuar stafin policor në analizimin e procesit, gjithashtu është përfshirë edhe Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) i cili ka bërë një inspektim të jashtëzakonshëm të këtij procesi.

Bazuar në të gjeturat e stafit policor të angazhuar për analizim të procesit si dhe raportit të inspektimit të IPK-së, Policia e Kosovës ka marrë vendim në muajin korrik për anulimin e këtij konkursi.

Përtej rekrutimit dhe gradimit, Polica ka prioritet zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punonjësve të saj. Zyrtarëve policor u ofrohen rregullisht trajnime dhe njohuri bashkëkohore në fushën e zbatimit të ligjit. Kjo përfshin trajnime mbi kornizat më të fundit ligjore, teknikat hetimore, përparimet teknologjike dhe fusha të specializuara si krimi kibernetik, kundërterrorizmi dhe policimi në komunitet.

Andaj, Policia gjatë këtij viti përkundër angazhimeve të mëdha operationale, ka arritur të organizojë dhe të administrojë gjithsej **1,430** trajnime, që krahasuar me vitin 2023 tregon *ngritje* për **7.43%**. Nga Divizioni i Trajnimeve janë realizuar: **400** trajnime për **9,335** pjesëtarë të saj dhe **128** ricertifikime për **1,709** zyrtarë policorë. Në bashkëpunim me organizata të tjera janë organizuar **490** trajnime për **5,237** pjesëtarë të saj. Ndërsa, jashtë vendit janë organizuar **403** aktivitete (trajnime, takime, konferenca) për **1,036** zyrtarë policorë. Gjatë kësaj periudhe Divizioni i Trajnimeve ka organizuar **9** trajnime për organizatat tjera, në të cilat kanë marrë pjesë **289** pjesëmarrës.

Po ashtu në proces është edhe studimi në Fakultetin e Sigurisë Publike me pjesëmarrjen e studentëve për 4 vitet akademike.

Tabela nr.19: Trajnimet e realizuara gjatë vitit 2024 dhe krahasimi me vitin 2023

Aktivitetet	2023		2024		Përqindja e trajnimeve
	Trajnime	Pjesëmarrës	Trajnime	Pjesëmarrës	
Trajnimet e realizuara nga Divizioni i Trajnimeve	289	5661	400	9335	38.4
Ricertifikimi	221	2599	128	1709	-42.08
Trajnimet e realizuara nga organizatat tjera në bashkëpunim me Divizionin e Trajnimeve	492	4879	490	5237	-0.4
Trajnime për organizata të tjera	5	99	9	289	80
Trajnimet, seminarët dhe konferencat e mbajtura jashtë vendit	324	729	403	1035	24.38
Gjithsej	1331	13967	1430	17605	7.43

Për të çmuar punën e palodhur, përkushtimin dhe shërbimin e jashtëzakonshëm dhe për t'i motivuar punonjësit e Policisë që ata të vazhdojnë të performojnë me standarde të larta, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka shpërblyer me medalje policore, lëvdatë dhe mirënjohje gjithsejtë **288** punonjës dhe **2** qytetar. Prej tyre: **1** Medalje Mburojë e Policisë, **14** Medalje për Shërbim të Dalluar, **142** Medalje Policore për Lëvdim, **105** Lëvdata dhe **28** Mirënjohje.

Gjatë këtij viti ka vazhduar implementimi i Strukturës organizative të Policisë së Kosovës si dhe sistemet dhe caktimet bazuar në listën e personelit të autorizuar.

Policia i jep përparësi shëndetit dhe mirëqenies sociale të punonjësve të saj duke ofruar programe gjithëpërfshirëse dhe sisteme mbështetëse që adresojnë kërkesat fizike dhe mendore të punës së policisë. Me synimin e identifikimit të hershëm të sëmundjes dhe ofrimit të mbështetjes mjekësore dhe psikologjike për punonjësit e Policisë, është nënshkruar vazhdimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të Policisë së Republikës së Kosovës dhe Shërbimit Spitalor të Klinikës Universitare të Kosovës për Shërbim Mjekësor dhe Psikologjik të personelit policor dhe rekrutëve.

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë së Komunës së Prishtinës, në muajin tetor-rozë, për sensibilizimin dhe identifikimin e hershëm të kancerit të gjirit, është arritur një marrëveshje mjaft me rëndësi për shëndetin e gruas, për mundësinë e kryerjes së mamografisë falas në Prishtinë për 327 pjesëtarët e Policisë së Kosovës, mbi moshën 40 vjeçare.

Po ashtu ekipi mjekësor nga DSHSH ka asistuar në **41** urdhra operative si dhe ka realizuar kampanjën e dhurimit të gjakut, që ka rezultuar me **536** dhurues të gjakut.

Policia ka përgatitur projektpropozimin për themelimin e “Qendrës diagnostikuese specialistike për kontrollim mjekësor për personelin policor të Policisë së Kosovës”.

Kjo qendër do të ofrojë shërbime të plota mjekësore për personelin policor dhe rekrutët në Policinë e Kosovës, duke u fokusuar në ofrimin e kontrolleve të rregullta mjekësore dhe specialistike, duke përmirësuar cilësinë e kujdesit shëndetësor, diagnostikimin e hershëm të sëmundjeve, trajtimin dhe kujdesin për rehabilitim, duke u përshtatur në mënyrë specifike për sfidat unike të shëndetit fizik dhe mendor, me të cilat përballen punonjësit e zbatimit të ligjit.

Shërbimet mbështetëse

Për të përmbushur të gjitha këto obligime me sukses, Policia e Kosovës, për vitin 2024 ka pasur në dispozicion buxhetin prej **169,647,853.02€**, të cilin e ka realizuar në masë prej **98.56%**.

Tabela nr.22: Kategoritë e shpenzimeve ekonomike

Kategoritë e shpenzimeve ekonomike	Buxheti 2024	Buxheti 2023	Ndryshimi	Shprehur në %
Pagat dhe shtesat	114,417,829.96	106,300,232.80	8,117,597.16 €	7.64%
Mallrat dhe shërbimet	22,718,542.65	18,784,949.34	3,933,593.31 €	20.94%
Shpenzimet kapitale	29,482,620.00	31,702,485.00	-2,219,865.00 €	-7.00%
Shpenzimet komunale	1,360,250.00	1,360,250.00	0.00 €	0.00%
Subvencionet dhe transferet	1,668,610.41	1,551,129.00	117,481.41 €	7.57%
TOTALI	169,647,853.02 €	159,699,046.14 €	9,948,806.88 €	6.23%

Shuma e përgjithshme e të hyrave për këtë periudhë kohore ka qenë **23,923,151.80€** prej tyre **19,223,502.84€** nga gjobat në trafik.

Gjatë vitit 2024 janë nënshkruar 152 kontrata prej tyre: a) 101 për furnizime; b) 25 për shërbime; c) 22 për punë; d) 2 për shitje dhe e) 2 për konkurse të projektimit.

Gjatë vitit 2024 janë realizuar apo janë në përfundim e sipër disa projekte të ndërtimit si: a) Stacioni Policor – Hani i Elezit; b) objekti i garazhit në QNJS “Enver Zymeri”; c) depo në QNJS “Enver Zymeri”.

Gjatë kësaj periudhe është siguruar mbështetje logjistike për të gjitha nivelet e PK-së, me qëllim të realizimit të aktiviteteve operative dhe administrative dhe policia është furnizuar me armë të gjata të llojeve dhe kalibrave të ndryshëm, me automjete patrulluese dhe automjete civile, me kombi të ndryshëm, me automjete të blinduara, autoblanda, me pajisje - smart patrulla (pajisje të mençura për trafik), me radar të avancuar për matje të shpejtësisë dhe me pajisje tjera të veçanta/speciale për njësitë e specializuara.

Policia i ka vënë theks të veçantë modernizimit të teknologjisë së informacionit, krahas zgjerimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të komunikimit dhe menaxhimit të informacionit.

Në përputhje me misionin e saj, Policia është e përkushtuar të rrisë kapacitetet, duke zbatuar teknologji të avancuara që mbështesin operacionet e Policisë, forcojnë masat e sigurisë dhe drejtojnë proceset e përgjithshme për të lehtësuar aktivitetet më efikase të zbatimit të ligjit.

Gjatë vitit 2024, Policia ka bërë përparim të dukshëm në këto fusha, duke investuar dhe avancuar në infrastrukturën kyçe të TI-së, kjo përfshin përmirësime në infrastrukturën e serverëve, sigurinë kibernetike, infrastrukturën e rrjetit, bazat e të dhënave, aplikacionet, komunikimin me radio, kamerat e sigurisë, sistemet VOIP dhe shërbimet mbështetëse të TIK-ut.

Disiplina dhe kontrolli i brendshëm

Policia monitoron, kontrollon dhe heton veprimet e zyrtarëve të saj për të siguruar llogaridhënie dhe profesionalizëm. Si rezultat i këtij kontrolli të brendshëm, sjelljet e pahijshme identifikohen dhe adresohen, duke siguruar që policët t'u përmbahen standardeve etike dhe të ruajnë besimin e publikut në zbatimin e ligjit.

Si rezultat i kësaj kontrole të brendshme gjatë kësaj periudhe Drejtoria për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të së Kaluarës ka administruar **932** lëndë disiplinore, prej tyre **648** lëndë të hapura gjatë vitit 2024 dhe **284** lëndë të bartura nga vitet paraprake. Gjatë kësaj periudhe janë përfunduar gjithsej **653** lëndë, prej të cilave **254** kanë qenë të bazuara dhe **339** të pa bazuara/të pa argumentuara.

Në Komisionin e Brendshëm Disiplinor janë pranuar **254** lëndë dhe janë shqyrtuar **245** lëndë. Janë nxjerrë **461** vendime disiplinore, nga të cilat: **23** raste të ndërprerjes së marrëdhënies së punës; **126** raste ndalesë në pagë mujore bruto për shkelje të rëndë; **5** transfere disiplinore; **46** raste ndalesë në pagë mujore bruto për shkelje të lehtë; **62** vërejtje me shkrim; **26** vërejtje me gojë; **15** raste është përgjegjëse për shkelje disiplinore dhe lirohet nga shqiptimi i masës disiplinore.

Komisioni i Ankesave ka pranuar **528** ankesa, ndërsa ka shqyrtuar **524** ankesa, prej të cilave: **366** ankesa janë refuzuar; **26** ankesa të aprovuara; **70** ankesa kanë qenë pjesërisht të aprovuara; **21** lëndë janë kthyer në plotësim të hetimeve/rishqyrtim dhe rivendosje, ndërsa **41** ankesa janë hedhur poshtë pasi që janë parashtruar jashtë afatit, është tërhequr nga ankuesi, i pabazuar apo ankesa nuk ka përmbajtur arsye të mjaftueshme.

Kontrolli i brendshëm i Policisë është fuqizuar edhe me auditimet dhe inspektimet e brendshme. Si rezultat i kësaj kontrole, gjatë periudhës raportuese Zyra e Auditimit, në kuadër të Policisë, ka realizuar **13** auditime të rregullta për të cilat ka dhënë **69** rekomandime. Këto auditime janë bërë në fusha të ndryshme të zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore që lidhen me fushën e prokurimit, financave dhe menaxhimit të pasurisë si dhe në fushën e zbatimit të procedurave administrative për personelin e Policisë.

Në kuadër të inspektimeve të brendshme, Policia ka realizuar **37** inspektime të rregullta si dhe **35** inspektime të jashtëzakonshme në të gjitha fushat e inspektimit të punës së Policisë. Për të gjeturat e këtyre inspektimeve janë dhënë **86** rekomandime në fushën e: (a) administrimit të rasteve penale dhe rasteve disiplinore në nivelin lokal, funksionimit të qendrave të ndalimit si dhe administrimit/menaxhimit të aksidenteve të trafikut rrugor.

Përveç inspektimeve të rregullta, janë realizuar inspektime të jashtëzakonshme, në fushën e avancimit të disiplinës së punonjësve të PK-së.

Bashkëpunimi me publikun - mediat

Në vitin 2024, policia vazhdoi të forconte bashkëpunimin e saj me mediat për të ndarë informacione thelbësore, për të rritur ndërgjegjësimin për çështjet e sigurisë publike dhe për të nxitur besimin e komunitetit. Raportimi në kohë dhe i saktë, në partneritet me median ka ndihmuar në informimin e qytetarëve për operacionet në vazhdim, masat e sigurisë dhe iniciativat parandaluese, duke promovuar gjithashtu llogaridhënien dhe transparencën në aktivitetet e zbatimit të ligjit.

Deri më sot, Policia ka krijuar një model informacioni gjithëpërfshirës, duke shfrytëzuar komunikatat ditore, raportet e rregullta (ditore, javore, mujore dhe vjetore), përditësimet specifike për rastet, konferencat për shtyp dhe përmbajtjen vizuale si foto lajmet për të komunikuar në mënyrë efektive me publikun dhe të sigurojë rrjedhën transparente të informacionit.

Tabela nr.23: Aktivitetet e mediave

Mediat elektronike dhe të shkruara	2023	2024	0.05
Komunikata me shkrim për media	2130	1775	-16.67
Raporte 24-orëshe	365	365	0
Aktivite, fotolajme, dokumente të ndryshme policore në rrjetet sociale	2233	2567	14.96
Kërkesa për qasje në dokumente publike të trajtuara	154	133	-13.64
Konferenca për shtyp dhe intervista në nivel qendror	14	20	42.86
Të dizajnuara dhe të publikuara, dokumente të ndryshme (plane, fushata vetëdijesuese, posterë etj).	70	76	8.57

Në vitin 2024, Policia e Kosovës hartoi dhe publikoi revistën e saj zyrtare, 'MBROJTËSI', e disponueshme në të tri gjuhët zyrtare të vendit. Ky publikim shërben si platformë për të nënvizuar të arriturat, aktivitetet dhe përpjekjet e vazhdueshme të Policisë së Kosovës, si dhe për t'i komunikuar informacione të rëndësishme si publikut ashtu edhe personelit policor. Duke u botuar në shumë gjuhë, ai siguron qasjen dhe forcon lidhjen midis forcave të Policisë dhe komuniteteve të ndryshme të cilave u shërben.

Policia ka nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me RTK-në për prodhimin dhe transmetimin e emisioneve policore që nxjerrin në pah punën, përkushtimin dhe funksionimin e suksesshëm të Policisë. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është të rrisë imazhin, besueshmërinë dhe transparencën e Policisë, duke i ofruar publikut informacion të saktë dhe profesional për aktivitetet e Policisë.

Përmes transmetimit mujor të emisionit "Uniformat blu", të transmetuar në Radio Televizionin e Kosovës, qytetarët do të njoftohen për përpjekjet dhe operacionet e Policisë. Programi synon gjithashtu të nxisë partneritete më të forta midis Policisë dhe komunitetit, duke promovuar parandalimin dhe luftën kundër krimit. Episodi i parë u transmetua me sukses në fund të vitit 2024.

Operacion i veçantë

28.11.2024 Rasti i sulmit terrorist me granatë dore në objektin e Komunës në Zveqan, që si pasojë e të cilit sulm janë shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale në objektin e Komunës, por edhe të veturave të parkuara përreth.

29.11.2024 – Rasti i sulmit terrorist ndaj infrastrukturës kritike të Republikës së Kosovës, në fshatin Varage / Ugjlare, Zubin Potok, që kishte për shënjestër kanalin e Ibër Lepencit, i cili bënë furnizimin me ujë të pijshëm të disa komunave, por edhe mbi të gjitha furnizimin me ujë për ftohje të termocentraleve të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Për realizimin e këtij sulmi terrorist, në bazë të hetimit të vendit të ngjarjes, dyshohet që në këtë sulm është përdorur një sasi e konsiderueshme e eksplozivit (rreth 20 kg) e cila ka qenë e vendosur në një çantë të zezë dhe e cila është aktivizuar me detonator mekanik përmes fitilit ndezës, me djegie të ngadalshme. Si pasojë e këtij sulmi, janë shkaktuar dëme të mëdha materiale në kanalin e Ibër Lepencit, si pasojë e të cilave është ndërprerë furnizimi me ujë të pijshëm për shumë zona dhe lokalitete, si dhe duke rrezikuar tej mase edhe furnizimin me energji elektrike apo edhe rrezikun me pasoja më të rënda për avari në Sistemin Energjetik të Republikës së Kosovës.

Me 6 shtator 2024, Policia shënoi 25 vjetorin e saj, duke shpalosur për herë të parë himnin e Policisë dhe marshin. Kjo ngjarje plotësoi grupin e simboleve të Policisë që përfaqësojnë vlerat, misionin dhe përkushtimin e saj në shërbim të qytetarëve dhe shtetit.

Po ashtu, në këtë vit, Policia themeloi edhe shoqatën e saj të sporteve. Shoqata synon të integrohet në federata të ndryshme sportive, duke u fokusuar fillimisht në disiplina si futbollit i vogël, volejboli, xhudo, atletika, gjuajtja dhe shahu. Kjo nismë synon të forcojë lidhjen e Policisë me komunitetin dhe të shfaqë disiplinën dhe profesionalizmin e oficerëve përtej detyrave të tyre zyrtare.

Sfidat e Policisë

Gjatë kryerjes së detyrave të saj, Policia e Kosovës përballlet me disa sfida të vazhdueshme, duke përfshirë:

- Mosanëtarësimi në Interpol dhe organizata të tjera ndërkombëtare të sigurisë, duke kufizuar bashkëpunimin e tij global dhe aftësitë e shkëmbimit të informacionit.
- Shqetësimet e sigurisë në rajonet veriore të vendit, që paraqesin sfida operacionale dhe të stabilitetit.
- Infrastruktura dhe logjistika e pamjaftueshme, duke penguar operacionet efikase dhe efektive të zbatimit të ligjit.
- Financim i kufizuar në fusha të caktuara, duke ndikuar në burimet dhe kapacitetin operacional.
- Forca e vjetër e Policisë, e cila paraqet sfida për sa i përket përvojës kundrejt kërkesave fizike.
- Kërcënimet hibride, të tilla si sulmet kibernetike dhe dezinformatat, duke komplikuar përpjekjet për të ruajtur sigurinë dhe besimin e publikut.

Objektivat strategjike për vitin 2025

Objektivi 1 - Ngritja e efikasitetit në ruajtjen e sigurisë publike, parandalimin, hetimin dhe zbulimin e krimit si dhe kontrollin kufitar;

Objektivi 2 - Reformimi i organizatës policore në funksion të ngritjes së efikasitetit operacional;

Objektivi 3 - Modernizimi dhe standardizimi i infrastrukturës;

Objektivi 4 - Avancimi i menaxhimit të burimeve njerëzore, ngritja e integritetit dhe efikasiteti i shërbimeve mbështetëse;

Prioritetet për vitin 2025

- Menaxhimi i situatës së sigurisë në veri të vendit për të garantuar stabilitet dhe paqe
- Rritja e parandalimit të krimit dhe sigurisë në trafik, duke u fokusuar në uljen e aktivitetit kriminal dhe përmirësimin e sigurisë rrugore
- Forcimi i hetimit dhe luftës kundër veprave penale, duke përfshirë trafikun e drogës, korrupsionin, krimin kibernetik dhe krimet e luftës
- Nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndërinstitucional për të përmirësuar sigurinë dhe shkëmbimin e informacionit me rëndësi
- Përmirësimi i mirëqenies së punonjësve të Policisë së Kosovës, sigurimi i kushteve më të mira të punës dhe mbështetje për policët
- Investimi në modernizimin e infrastrukturës dhe pajisjeve të PK-së, përmirësimin e mjeteve dhe objekteve për operime më efikase
- Zhvillimi i burimeve njerëzore përmes rekrutimit dhe trajnimit të avancuar në fusha të specializuara, për të ndërtuar një fuqi punëtore më të aftë

